



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. i Dokumentit: 21.1.7-2017-08

RAPORT I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR PËR PROJEKTIN
"PËRKRAHJE PËR PËRMIRËSIMIN E HARTIMIT (ZHVILLIMIT) TË
POLITIKAVE NË KOSOVË"
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Auditim në bazë të marrëveshjes me SIDA-në

Prishtinë, prill 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Raportin Vjetor Financiar për Projektin “Përkrahje për Përmirësimin e Hartimit (Zhvillimit) të Politikave në Kosovë”, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Qëndresa Sogojeva (udhëheqëse ekipi) dhe Lumturije Sopi (anëtare), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak.....	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi	21

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky draft raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor për projektin “Përkrahje për Përmirësimin e Hartimit/Zhvillimit të Politikave në Kosovë”, për vitin e përfunduar më 31.12.2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm.


Fondi për përmirësimin e zhvillimit të politikave në Kosovë është krijuar në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës (përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit), përmes Sekretariatit Koordinues të Qeverisë dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar. Projekti ka tre synime kryesore në drejtim të përmirësimit të performancës së zyrave të Zyrës së Kryeministrit në kornizën aktuale të detyrave:

- krijimi i bazave të qarta mbi të cilat mund të ndërtohen procedurat e zhvillimit të politikave në Kosovë;
- ngritja e kapaciteteve dhe zgjerimi i kornizave të shkathtësive të stafit kyç për zhvillimin dhe koordinimin e politikave; dhe
- përmes Zyrës së Kryeministrit, ngritja e kapaciteteve të ministrive të linjës në pajtim me detyrat që stafi i këtyre ministrive duhet të përmbushë.

Objektiva pasqyron prioritetet e Qeverisë së Kosovës për reformën në Administratën publike, si shumë të rëndësishme për menaxhimin dhe zhvillimin ekonomik dhe avancimin në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

Ekzaminimi i raportit financiar për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me raportin financiar.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin e vitit 2017 është përcaktuar varësisht nga shpenzimet e ndodhura për këtë periudhë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Zyrës së Kryeministri për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Raporti Financiar Vjetor për vitin 2017 *paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Përgjigja e Sekretarit të Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në bazë të marrëveshjes/kontratës me Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e raportit financiar dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse raporti financiar jep një pamje të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat, sistemet dhe transaksionet financiare janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në zbatim;
- Kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës, përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit (ZKM/SKQ), si dhe Suedisë, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA);
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin si dhe detyrat shtesë sipas procedurave të dakorduara.

Metodologjia e auditimit është fokusuar në ekzaminimin e të dhënave dhe transaksioneve financiare, përfshirë dokumentacionin mbështetës. Ne kemi përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit.

Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i raportit financiar vjetor merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në raportin financiar. Po ashtu ne kemi konsideruar edhe krahasimin e realizimit të shpenzimeve në raport me planifikimin e aktiviteteve të projektit.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar Raportin Financiar të projektit të financuar nga SIDA "Përkrahje për Përmirësimin e Hartimit (Zhvillimit) të Politikave në Kosovë", për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 i cili përfshinë shpenzimet, një përmbledhje të krahasimit të buxhetit më shumë aktuale dhe shënime shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, Raporti Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit (ZKM), është përgjegjëse për zbatimin e projektit dhe për menaxhimin e kontributeve financiare nga SIDA. Mbështetja financiare e SIDA-së përbëhet nga dy pjesë: kontributi i drejtpërdrejt tek Qeveria (Thesar) si dhe pagesat për asistencë teknike. ZKM është përgjegjëse për mbajtjen e kontabilitetit si dhe për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të raportit vjetor financiar.

Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për raportin financiar, në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtij raporti financiar.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në raportim financiar. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në raportin financiar, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e raportit financiar nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të raportit financiar.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga ZKM-ja kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës, përfaqësuar nga ZKM, përmes Sekretariatit Koordinues të Qeverisë (SKQ), si dhe Suedisë, përfaqësuar SIDA;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, (me plotësim ndryshimet); dhe
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 për shpenzimin e parave publike.

Në lidhje me fondet e shpenzuara nga ZKM-ja është përgatitur raporti përmbledhës, derisa ky raport më tej do të përfshihet në Pasqyrat Financiare Vjetore të “Konsoliduara” të ZKM-së. Raportimi financiar është bërë në përputhje me marrëveshjen, po ashtu është përgatitur raporti narrativ i cili përmban një analizë mbi progresin e aktiviteteve të projektit dhe rezultatet.

Në kontekst të raportimit, ne nuk kemi çështje për të ngritur.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, planifikimin, çështjet e prokurimit, procesin e pagesave dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sistemi financiar dhe kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të mira dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Sistemet dhe transaksionet financiare janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe në pajtim me kërkesat e marrëveshjes. Disa mangësi të vogla sa i përketë realizimit të buxhetit dhe mbylljes së avancave janë shpalosur në vijim.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne kemi shqyrtuar planifikimin në bazë të linjave buxhetore të SIDA-së dhe shpenzimet e tyre. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas linjave buxhetore të SIDA-s (në €),

Përshkrimi	Buxheti planifikuar 2017	2017 Realizimi	Buxheti planifikuar 2016	2016 Realizimi
Llojet e shpenzimeve/totali	311,500	186,506	95,000	72,692
Konferencat	50,000	0	15,000	1,510
Vizita studimore në Suedi	31,200	31,322	0	0
Vizita studimore në Belgjikë	31,300	38,194	0	0
Pagat për praktikantë	15,000	14,455	10,000	9,970
Pajisje për zyre	3,500	4,272	10,000	6,276
Përkthime	25,000	4,500	10,000	4,303
Sallat e takimeve/shpenzimet e takimit	45,000	45,084	30,000	30,752
Socializmi (Team Building)	2,500	362	0	0
Trajnimet	35,000	12,027	0	0
Punëtoritë me vendet partner	20,000	25,941	20,000	19,882
Punëtoritë RBM - MBR (menaxhmim i bazuar në rezultate)	10,000	0	0	0
Audtimi vjetor	3,000	2,415	0	0
Mbështetje për konsultim	40,000	7,933		

Sipas shënimeve të Thesarit buxheti për vitin 2017 ishte 317,477€, prej tyre mjete të bartura nga viti 2016 ishin 213,390€ si dhe 104,087€ mjete të vitit 2017.

Sekretariati Koordinues i Qeverisë (SKQ) dhe ekipi implementues i projektit kanë mbajtur evidenca të shpenzimeve sipas linjave buxhetore të planifikuara, në bazë të marrëveshjes më datë 15.12.2015 dhe të rishikuar më 02.02.2017 (shih tabelën 1). Si rrjedhojë planifikimi buxhetor është për 5,977€ më ulët se buxheti në dispozicion. Rishikimi i marrëveshjes ka ndikuar në përmirësimin e trendit buxhetor të projektit.

Nga tabela vërehet se në tre linja buxhetore është tejkeluar planifikimi:

- Në kuadër të shpenzimeve për vizitat studimore në Suedi dhe Bruksel, buxheti është tejkeluar për 7,016€, kjo ka ndodhur pasi në këto linja janë përfshirë edhe shpenzimet e përkthyesve/përkthimet, si rezultat i faturës së përbashkët me pjesën tjetër të grupit (biletat e udhëtimit dhe shpenzimet e akomodimit¹). Kjo ka ndikuar që shpenzimet në linjën e përkthimeve të reflektohen më të ulëta se sa janë realisht;
- Buxheti për seminarët më vendet partnere (bashkëpunim rajonal) është tejkeluar për 5,941€, kjo si rezultat i lidhjes së marrëveshjes me Shqipërinë për shkëmbimin e përvojave dhe për bashkëpunimin lidhur me zbatimin e rregullimit më të mire dhe vlerësimit të ndikimit të politikave; dhe
- Linja buxhetore, pajisje për zyre është tejkeluar për 772€ në raport me planifikimin e bazuar në marrëveshje. Tejkalimi vërehet pasi në planifikim nuk janë përfshirë mjetet e pashpenzuara nga viti paraprak, në vlerë 3,724€ si dhe porosia e pajisjeve është bërë në 2016, ndërsa fatura është pranuar në 2017.

Në vitin 2017, janë shpenzuar 59% të buxhetit final ose 186,506€, dhe se krahasuar me vitin 2016 kemi një ulje të nivelit të realizimit për 18%. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm.

¹ Përkthimet janë parashikuar në një linjë tjetër buxhetore të cilat nuk janë realizuar plotësisht

Çështja 1 - Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

E gjetura Sipas nenit 9.2 të marrëveshjes në mes Qeverisë dhe Ambasadës Suedeze, Qeveria do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Ambasadës së Suedisë buxhetin e azhurnuar në baza vjetore, që do të përfshijë periudhën janar - dhjetor të vitit të ardhshëm fiskal. Derisa buxheti duhet shpenzuar sipas aktiviteteve dhe kohës së planifikuar.

Qeveria ka planifikuar dhe dorëzuar buxhetin sipas kërkesave të marrëveshjes, mirëpo me rastin e planifikimit nuk janë marrë parasysht/përfshirë mjetet e pashpenzuara të vitit paraprak. Si rrjedhojë buxheti i planifikuar ishte më ulët për 5,977€ se sa mjetet në dispozicion². Rishikimi i marrëveshjes bazë në fillim të vitit 2017 ka ndikuar që diferenca ndërmjet buxhetit të planifikuar dhe në dispozicion të mos jetë aq e lartë.

Niveli i shpenzimit/realizimit të buxhetit për vitin 2017 nuk është në nivelin e pritur (59%). Kjo situatë është për arsye të vonesave në zhvillimin e aktiviteteve që nga fillimi i projektit. Si rrjedhojë një pjesë e konsiderueshme e mjeteve janë bartur nga viti 2016.

Rreziku Planifikimi i buxhetit duke mos përfshirë të gjitha mjetet në dispozicion për shpenzim nuk është real dhe mund të sjell mos-harmonizim ndërmjet aktiviteteve dhe buxhetit si dhe mund të ndikoj negativisht në realizimin e buxhetit. Ndërsa realizimi i ulët i buxhetit tregon mos efikasitet dhe rrezikon arritjen e objektivave të projektit.

Rekomandimi 1 Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me SKQ-në duhet të sigurojë planifikim cilësor të buxhetit duke marrë parasysht mjetet në dispozicion. Derisa performanca e realizimit të buxhetit të rishikohet në mënyrë sistematike, në mënyrë që të mënjanohen pengesat dhe të arrihen objektivat/rezultatet e planifikuara operative dhe financiare.

² Mjete e bartura ishin 213,390€ dhe kësti i parashikuar me marrëveshje 104,087€ që në total janë 317,477€.

3.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 317,477€³. Prej tyre janë shpenzuar 186,506€. Ato kanë të bëjnë me avancet, shpenzime për dreka zyrtare, shpenzime të udhëtimit jashtë vendit, mëditje të udhëtimit jashtë vendit dhe pagesat për praktikant.

Ne kemi kryer teste për këto shpenzime për të marr siguri se janë respektuar të gjitha rregullat në fuqi.

Çështja 2 – Vonesa në mbylljen e avanceve

E gjetura Sipas nenit 8, të udhëzimit administrativ nr. 2004/07 për udhëtime zyrtare, obligon të gjithë zyrtarët që të sjellin dëshmitë për shpenzimet e bëra lidhur me avancet e marra brenda afatit 15 ditor pas përfundimit të vizitës zyrtare.

Ne identifikuam katër raste ku vonesat ishin më shumë se dy muaj, ndërsa një rast për shpenzimet në shkollën verore për politikë publike në vlerë 2,830€ ishte arsyetuar gjashtë muaj më vonë (shkurt 2018).

Rreziku Mos arsyetimi i avancave më kohë është në kundërshtim me rregullat në fuqi dhe rrezikon që paratë e shpenzuara të mos arsyetohen dhe mos arrijnë qëllimin e duhur.

Rekomandimi 2 Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me SKQ-në duhet të sigurojë që të respektohet afati ligjor për mbylljen e avanceve dhe me qëllim të ruajtjes së parësë publike duhet të siguroj llogaridhënie për shpenzimin e tyre.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 4,455€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Faturat e papaguara nuk kishin kaluar afatin ligjor prej 30 ditësh, por janë vendosur me prioritet dhe janë paguar në fillim të vitit 2018.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

³ Palnifikimi në tabelë është 311,500€ ndërsa buxheti në dispozicion ishte 317,477€.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për raportin financiar të vitit 2016 të projektit "Përkrahje për Përmirësimin e Hartimit (Zhvillimit) të Politikave në Kosovë", ka rezultuar në tre rekomandime.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, dy rekomandime janë zbatuar dhe një ishte në proces. Përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe gjendjen e zbatimit shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve dhe qeverisjen e mirë mbi aktivitetet e zhvilluara dhe menaxhimin financiar.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti (SKQ) po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Raportimet periodike të bordit të drejtorëve të Zyrës së Kryeministrit dhe stafit përgjegjës për implementimin e projektit "Përkrahje për Përmirësimin e Hartimit (Zhvillimit) të Politikave në Kosovë".

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Zyra e Kryeministrit në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Funkcionon Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe ofron siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive, duke zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve tregon gatishmëri për përmirësim. Megjithatë janë disa segmente që organizata ka ende nevojë të përmirësoj kontrollin dhe qeverisjen. Planifikimi i aktiviteteve dhe menaxhimi i angazhimeve kanë shfaqur dobësi.

Më tej, ZKM nuk ka ndonjë strategji që ka të bëjë me konsulentët ndërkombëtarë dhe lokal, mirëpo bazohet në marrëveshje/kontrata dypalëshe të bazuara në udhëzime dhe procedura të vendosura.

Lidhur me strategjinë Anti-korrupsion ZKM bazohet në Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 më herët 2013-2017 me planet e veprimit, megjithëse brenda organizatës nuk shfaqen aktivitetet formale rreth kësaj çështje. Lidhur me raportimet online për aktivitetet e përgjithshme nuk ka ndonjë strategji apo program të hartuar/miratuar. Po ashtu procesi i blerjes së pajisjeve nuk është përcjellë deri në regjistrimin e tyre në regjistër të pasurive⁴.

Andaj Zyra e Kryeministrit duhet të zhvillohet ende në adoptimin e kërkesave/praktikave të mira me qasje strategjike.

5.1 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj planifikim të shpenzimeve në bazë të buxhetit në dispozicion.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, megjithatë ende ka nevojë për përmirësime në disa aspekte që mundësojnë përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

⁴ Çështja e regjistrimit të pajisjeve në vlerë prej 2,696€ do të trajtohet në Draft Raportin e ZKM për vitin 2017

Çështja 3 – Dobësi në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve-trajnimeve, punëtoritë, praktikat

- E gjetura** Në kuadër të pikës 4 të aneks marrëveshjes, ZKM (SKQ) duhet të zhvillojë një program trajnimi për zhvillimin e politikave që synojnë grupe të ndryshme brenda ministrive të linjës. Për vitin 2017, SQK dhe stafi implementues kanë planifikuar/hartuar një listë të përgjithshme të trajnimeve dhe punëtorive. Mirëpo, pjesa dërmuese e trajnimeve/punëtorive janë organizuar në bazë të kërkesave momentale. Prej 49 trajnimeve/punëtorive të organizuara, rreth 80% e tyre janë bërë nga kërkesat momentale. Por sipas zyrtarëve të SKQ aktivitetet kanë të bëjnë me përmbushjen e objektivave që parashihen në kornizën e rezultateve të projektit.
- E gjetura** Në kuadër të aneksit të marrëveshjes, pika 5.10 ka parashikuar dhënien e mundësisë studenteve për mbajtjen e praktikës në zyrat përkatëse të ZKM-së. Në vitin 2016, përzgjedhja e praktikantëve ishte bërë duke zbatuar procedurën të thjeshta të rekrutimit (njoftimin për ofrimin e praktikës, testimin me shkrim dhe intervistën e aplikantëve). Mirëpo nga testimet tona kemi vërejtur se dy praktikantë të angazhuar në vitin 2017, nuk janë përzgjedhur nga lista e ngushtë e kandidatëve të suksesshëm të propozuar nga komisioni i konkursit.
- Rreziku** Mungesa e planifikimit të detajuar të aktiviteteve, rrezikon që projekti të mos arrijë objektivat e pritura dhe në kohë. Po ashtu mund të ndikoj negativisht në realizimin e buxhetit, cilësinë e organizimit të aktiviteteve dhe rrjedhimisht në rezultatin e projektit. Pranimi i praktikantëve jashtë listës së ngushtë/procedurave të rekrutimit rritë rrezikun e angazhimit të stafit jo adekuat dhe pengon promovimin e konkurrencës së mirëfilltë.
- Rekomandimi 3** Sekretari i Përgjithshëm në koordinim më SKQ-në duhet të siguroj se është përcaktuar një planifikim i mirë i aktiviteteve, i cili siguron arritjen e objektivave të projektit dhe do të maksimalizonte rezultatet e arritura kundrejt fondeve të pranuar nga donatori. Po ashtu të siguroj që proceset gjatë zhvillimit të aktiviteteve të promovojnë konkurrencë/transparencë të duhur.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me SKQ-në duhet të ndërmarrin një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në 2017.			I pazbatuar
Mallrat dhe shërbimet	Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me SKQ-në duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprime shtesë në mënyrë që regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në kodet ekonomike përkatëse.	Është zbatuar		
Obligimet e papaguara	Sekretari i Përgjithshëm në koordinim me SKQ-në duhet të sigurojnë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor në mënyrë që të shmanget ekzekutimi i pagesave drejtpërdrejtë nga thesari, apo rritja e obligimeve të papaguara në fund të vitit.	Është zbatuar		

Shtojca III: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
25.04.2018			
Nr. Zyrë 02	Nr. Zyrë 1312		
Nr. Prill 25	Nr. Prill 25 / 04 / 2018		
			
Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Qeveria - Vlada-Government Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister Sekretari i Përgjithshëm-Generalni Sekretar- Secretary General			

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Projektit "Përkrahje për Përmirësimin e Hartimit/Zhvillimit të Politikave në Kosovë", financuar nga SIDA, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Fitim Krasniqi
 Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit,

Data: 25.Prill,2018, Prishtinë